

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME E NDËRTIMIT "KARL GEGA" TIRANË**

Nr. 156 Prot.

Tiranë, më 03/03/2026

Lënda : Njoftim për lëvizje paralele për instruktor të praktikës profesionale

Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit Nr.15 datë 16.02.2017 , “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr 554 date 31.07.2019 “ Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punesimit dhe Aftësive (AKPA) , Udhëzimit të MFE, Nr.25, datë 01.09.2023 nr 15702 prot “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet arsimit profesional” Udhëzimit të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Nr.759, datë 30.09.2024 “PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE VEPRIMTARISË, MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE, PËRBËRJEN E NJËSISË SË ZHVILLIMIT TË INSTITUCIONEVE, OFRUESVE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL DHE ZHVILLIMIT TË VAZHDUAR PROFESIONAL TË PERSONELIT” Udhëzimi i Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 4, datë 18.8.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 759, datë 30.9.2024 ofruesi publik i AFP-së ,neni 118 pika 3. Shkolla e mesme e ndërtimit “Karl Gega”, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin :

**1- Instruktor I praktikës profesionale në drejtimin Termohidraulikë – 1 (Një)
Instruktor I Praktikës Profesionale**

Aplikanti për Instruktor të praktikës profesionale në ofruesit e AFP-së duhet të përmbushë këto kritere:

1. Kritere të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

2. Kriteria të posaçme për personelin Instruktor I praktikës profesionale në ofruesit e AFP-së, që ofrojnë arsim të mesëm profesional:


- a) të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale, pas të mesme ose parauniversitare në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale për të cilin/cilat po aplikon;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;
- d) aftësi të tjera nëse kërkohen.

3. Dokumentet e aplikimit Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
 - b) jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 të këtij udhëzimi;
 - c) kartën e identitetit;
 - d) diplomën;
 - e) librezën e punës;
 - f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
 - g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
 - h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
 - i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
 - j) vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
 - k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.
2. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.
3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të ofruesit publik të AFP-së, brenda afateve të aplikimit të përcaktuara në shpallje 25/03/2026

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin !

Konceptoi: B. Shehaj
Miratoi: I. Gorçe



DREJTOR
Ing. Indrit Gorçe

